



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR DATË
07.11.2022**

Me datë 07.11.2022, u mbajt mbledhja e këshillit bashkiak Shkodër. Këshilltarë të pranishëm ishin: Brisela Kadija, Teuta Zaja, Bledianë Nika, Ardiana Ndeu, Diana Muriqi, Tereze Brigja, Jona Leqeja, Daniela Jakoja, Ardita Spahija, Dhurata Tyli, Valbona Doniku, Sabina Danaj, Erion Metushi, Sokol Zaimaj, Vjollca Petani, Sabahet Lishi, Suada Selimaj, Donika Ndoja, Kristi Shllaku, Anton Kaftalli, Hilmi Lakti, Gerald Hasaj, Besmir Vukaj, Anton Deda, Gjergj Sokoli, Andi Hallunaj, Arbis Vjerdha, Nadir Spahija, Lulash Nika, Lush Marku, Julian Kraja, Ornela Leka.

Mbledhja hapet nga Kryetarja e Këshillit, znj. Brisela Kadija.

Rendi i ditës së mbledhjes është si vijon:

1. Pr/ Vendim *"Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike deri në 6% për muajin Shtator 2022"*
2. Pr/ Vendim *"Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike deri në 6% për muajin Tetor 2022"*
3. P/Vendim: *"Për miratimin e projektit të parë të programit buxhetor afatmesëm 2023-2025 për Bashkinë Shkodër".*
4. Pr/ Vendim *"Për shtesë në buxhetin e vitit 2022, e miratuar me VKB nr.3, datë 5.1.2022 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2022 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2022-2024 të Bashkisë Shkodër dhe detajimin e fondit të flokuar për emergjencat civile për vitin 2022"."*
5. Pr/Vendim: *"Për një shtesë në VKB nr.1, datë 22.1.2022," Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Shkodër".*
6. P/Vendim: *"Për miratimin e kërkesës së Bashkisë Shkodër së bashku me dokumentacionin tekniko-ligjor për akordimin e ndihmës së menjëhershme financiare për familjen e Z.Miri Kraja, Z.Bledar Vujoshi, Z.Fatmir Bushaj, Z.Muhamet Hysaj,*

Z.Veli Bushaj, Z.Nike Guri,dhe Z.Vasil Guri, banesat e të cilëve janë dëmtuar nga zjarri”.

7. Pr/ Vendim “Për një ndryshim në VKB nr.3 datë 05.01.2022 “ Për miratimin e buxhetit të vitit 2022 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2022-2024 të Bashkisë Shkodër, i ndryshuar.
8. Pr/ Vendim “Për miratimin e sistemeve të pikëzimit për programet e strehimit social për vitin 2022”.
9. Pr/ Vendim “Për strehimin emergjent të familjes së Osman Dushaj në njësitë e banimit tek banesat sociale me qira pranë qendrës komunitare” nr.6 (ish konvikti i shkollës pyjore”.
10. Diskutime jashtë rendit të ditës

Kourumi i domosdoshëm është i pranishëm në sallë, kryetarja e këshillit hap mbledhjen. Para se të vijohet me votimin e rendit të ditës Zv.Kryetari i bashkisë kërkon fjalën dhe shprehet në lidhje me pikën 3 të rendit të ditës, ai kërkon heqjen nga rendi i ditës i kësaj pike për arsye të mosefektit të saj sepse vjen në Këshill si vendim i vonuar.

Z.Vjerdha merr fjalën dhe kërkon që meqënëse rendi i ditës është i ngarkuar, mund të bëhet edhe një mbledhje tjetër.Gjithashtu ai shprehet se nuk është aspak normale që Kryetari i bashkisë nuk është prezent në mbledhje.

Znj.Kadija sqaron se për shkak të ngarkesës së këtij rendi me pr/vendime emergjente, nga fundi i muajit nëntor do vendoset për zhvillimin e një tjetër mbledhjeje të Këshillit bashkiak.

Hidhet në votim rendi i ditës me ndryshimin e propozuar nga zv/Kryetari, ku rezultojnë 29 vota Pro, 1 Kundër, 0 Abstenim.

Miratohet

Meqënëse dy pikat e para janë në lidhje me Ndihmën Ekonomike, ato do relatohen së bashku, por do votohen ndarazi.

1.Mbledhja vijon me Pr/Vendimin “Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike deri në 6% për muajin Shtator 2022” .

Relaton Z.Dedaj sipas materialit të përgatitur nga punonjësit e administratës. Kryetarët e grupeve shprehen dakort. projekt akti hidhet në votim, ku rezultojnë 31 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.

Miratohet

2. Vijohet me Pr/ Vendim "Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike deri në 6% për muajin Tetor 2022".

Kryetarët e grupeve shprehen dakort. Projekt akti hidhet në votim, ku rezultojnë 32 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.

Miratohet

3. Mbledhja vijon me Pr/ Vendim "Për shtesë në buxhetin e vitit 2022, e miratuar me VKB nr.3, datë 5.1.2022 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2022 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2022-2024 të Bashkisë Shkodër dhe detajimin e fondit të flokuar për emergjencat civile për vitin 2022". "

Fjala është përsëri për Z.Dedaj i cili relaton dhe sqaron disa nga problematikat e këtij Pr/akti.

Merr fjalën kryetari i komisionit të Emergjencave Civile, Z.Lakti i cili thekson që edhe Prefektura ka pasur një korrespondencë me Ministrinë e Financave për sa i përket ligjit në fjalë, konkretisht ligji 414 dhe nuk është aspak e vërtetë që Prefekti i Qarkut është bërë pengesë për kalimin e fondeve në destinacion, por e rëndësishme është që këto fonde të përdoren në mënyrë efëcente, prandaj kjo ka nevojë për kohën e vet.

Z.Dedaj përgjigjet që ky Pr/vendim është përgatitur që në muajin korrik, por mospasja e kourumit në Këshill bëri që të shtyhet dhe të miratohet me vonesë. E rëndësishme është që kjo t'i shërbejë komunitetit dhe qytetarëve. Ky është edhe qëllimi jonë i përbashkët.

Znj.Kadija sqaron që kuorumi i domosdoshëm nuk ka qënë asnjëherë pengesë për punën e Bashkisë dhe së dyti ajo citon pjesë të korespondencës së Prefektes me Ministrinë e Financave për të sqaruar edhe njëherë mosmiratimin në kohë të këtij Pr/Vendimi. Pra, shprehimisht fondet e destinuar për Emergjencat Civile të shkojnë në destinacionin e tij.

Z.Dedaj shprehet pa dashur të bëjë replikë, se VKM prevalon de jure mbi korrespondenca të tilla, dhe ne thjesht kërkojmë zbatimin e ligjit. Gjykimi dhe vendimmarrja është gjithmonë e juaja.

Znj.Leqejza merr fjalën dhe shprehet se komisioni i buxhetit e ka shqyrtuar që në korrik Pr/vendimin dhe ka shprehur dakortësi. Por ajo sqaron se Këshilli bashkiak nuk merret me ligjshmërinë e projekt vendimeve, ai thjesht ka efekt vendimmarrës. Vullneti jonë është që këto fonde të shkojnë për familjet e dëmtuara si mbështetje financiare dhe së dyti për rehabilitimin e rrugës së Dukagjinit. Dhe për të qënë transparent forma, përmbajtja dhe vlerat e këtij Pr/vendimi kanë ndryshuar nga ai i shqyrtuar në korrik dhe rekomandimet janë përmbushur, por në këtë rast nuk është fjala për të kaluar topin nga njëra fushë në tjetrën.

Z.Vjerdha shprehet shumë dakort me Znj.Leqejza duke shtuar se ekzekutivi i Bashkisë kërkon financim por harron se duhet edhe të përgjigjet për këtë. Ai nuk është kundër mbështetjes së familjeve të dëmtuara apo kundër rehabilitimit të rrugës së Dukagjinit, por është kundër diferencimit militantist të Bashkisë Shkodër, siç po ndodh edhe me Urën e Bunës që thoni se është jashtë kompetencave tuaja.

Z.Dedaj shprehet se këtu nuk bëhet fjalë për diferencim apo hipokrizi por ndoshta është çështje konsulence.

Znj.Selimaj nuk pëlqen faktin që flitet edhe debatohet për një institucion që nuk është i përfaqësuar në mbledhje dhe është e pafalshme që për këto “lojra” institucionale, qytetarët e dëmtuar “hallakaten” lart e poshtë qoftë edhe për një leje, kur duan të ndërhyjnë vetë për rregullime. Ajo nuk e di se çfarë përgjigje mund tu japin qytetarëve në këtë rast.

Z.Dedaj thotë se shqetësimi i zonjës për Urën e Bunës është evident dhe se ato e kanë shumë në konsideratë por problemi i vetëm është ligji.

Znj.Brigja merr fjalën dhe thotë që ajo personalisht nuk është juriste por beson që ky Këshill nuk është pa jurist që mund të merren me shqyrtimin e kësaj çështjeje në mënyrë që mos të bihet ndesh me miratim e bërë nga vetë ato. Ajo shton se rruga e Dukagjinit duhet të jetë patjetër prioritet.

Znj.Petani nuk dëshiron të replikoj por nuk është aspak dakort me faktin që zv/kryetari kërkon të fajësojë Prefekturën për shtyrjen e projekt vendimit.

Z.Dedaj sqaron se duhet të jemi korrekt kur citojmë njëri –tjetrin sepse ai nuk u shpreh që Prefektja me një dorë e jep dhe me tjetrën e merr sepse ajo nuk ka fond për të dhënë, por thjesht u shpreh, që ajo nëpërmjet korrespondencës mund të sqarojë destinacionin e fondit. Për t’u rikthyer edhe njëherë tek Ura e Bunës, përsëris që nuk është në administrimin e Bashkisë Shkodër.

Kalohet tek mendimet e kryetarëve të grupeve. Z.Sokoli përsërit nevojën e menjëhershme për ndërhyrje në rrugën e Dukagjinit dhe shprehet pro këtij projekt akti. Edhe Znj.Leqejza shprehet pro. Projekt akti hidhet në votim, ku rezultojnë 29 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.

Miratohet

Z.Marku merr fjalën dhe kërkon që të lihet mënjane politika dhe kalimi i përgjegjësisë nga njëra palë tek tjetra sepse ky Këshill ka treguar më së miri se sa bashkëpunues ka qënë. Përtej politikës nuk duhet të mbylлим sytë ndaj kërkesave dhe detyrimeve që i kemi qytetarëve. Dhe duhet të gjindet medoemos financimi për rrugën e Dukagjinit.

4. Mbledhja vijon me Pr/ Vendimin *“Për një shtesë në VKB nr.1, datë 22.1.2022.” Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Shkodër”.*

Fjala për Z.Luleta,drejtor i Shërbimeve Publike, i cili relatton sipas materialit të përgatitur nga punonjësit e administratës.

Znj.Ndreu në emër të komisionit të Shërbimeve publike shprehet pro këtij projekt vendimi.

Z.Vjerdha kërkon të dijë edhe njëherë se sa transparente është Bashkia Shkodër me destinacionin final të këtij fondi ,që vjen nga vjelja e taksave të qytetarëve.

Z.Dedaj sqaron dhe thekson faktin që ka edhe probleme në mbledhjen e taksave por asnjëherë nuk ka diferencim në lidhje me fushatën elektorale nëse nënkuptohet diçka e tillë.

Kalohet tek mendimet e kryetarëve të grupeve, të cilët shprehin dakortësi për projekt aktin. Projekt akti hidhet në votim, ku rezultojnë 27 vota Pro, 1 Kundër, 0 Abstenim.

Miratohet

5. Mbledhja vijon me Pr/ Vendimin "Për miratimin e kërkesës së Bashkisë Shkodër së bashku me dokumentacionin tekniko-ligjor për akordimin e ndihmës së menjëhershme financiare për familjen e Z.Miri Kraja, Z.Bledar Vujoshi, Z.Fatmir Bushaj, Z.Muhamet Hysaj, Z.Veli Bushaj, Z.Nike Guri,dhe Z.Vasil Guri, banesat e të cilëve janë dëmtuar nga zjarri".

Relaton përsëri Z.Dedaj sipas materialit të përgatitur nga punonjësit e administratës. Kryetarët e grupeve shprehen dakort. projekt akti hidhet në votim, ku rezultojnë 27 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.

Miratohet

6. Mbledhja vijon me Pr/ Vendimin "Për një ndryshim në VKB nr.3 datë 05.01.2022 " Për miratimin e buxhetit të vitit 2022 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2022-2024 të Bashkisë Shkodër, i ndryshuar.

Relaton Znj.Hila sipas materialit të përgatitur nga punonjësit e administratës.

Fjalën e merr Znj.Leqejza në emër të komisionit të çështjeve sociale, e cila shprehet që ky pr/vendim vjen si një nisëm e grave këshilltare dhe jo vetëm. Kjo do jetë një risi për Shkodrën dhe një ndihmë e madhe për familjet përfituese. Ajo shprehet pro dhe përshëndet vullnetin e Bashkisë Shkodër në hedhjen e hapit të parë në këtë drejtim.

Z.Vjerdha përgëzon nismën dhe shpreson në rezultate sa më të mira por dëshiron të dijë se çfarë kriteresh do ndiqen për punësimin e këtyre personave?

Znj.Hila sqaron se ligji i arsimit shprehet qartë mbi kriteret e punësimit. Në këtë rast do bashkëpunohet me ZVA, për të marr parasysh portalin, që të jemi transparent dhe të drejtë në përzgjedhje.

Znj.Ndreu shprehet se duke qënë fushës, e sheh si shumë të vështirë gjetjen e punonjësve të specializuar për këtë target grup fëmijësh. Duhet të ndiqet me shumë rigorozitet zgjedhja e personave të duhur.Thekson faktin që ZVA e Shkodrës nuk ka njerëz të specializuar, si mendohet të zgjidhet kjo pjesë?

Znj.Hila edhe njëherë shprehet se zgjidhja do gjindet patjetër kur ekziston dëshira e mirë dhe duke mos shkelur në asnjë moment standardet dhe ligjin. Dhe çdo gjë do jetë në bashkëpunim me ZVA-në.

Znj.Selimi thotë që ajo është shumë dakort për hapjen e vendeve të tilla. Dhe mendon që ZVA, duke njohur ligjin dhe kriteret e specializimit do bëjë më të mirën, ndoshta kjo mund të arrihet edhe me lëvizje paralele, ku një punonjëse me arsimin e trajnimitin përkatës të shkojë në kopshtin ku ka fëmijë që kanë nevojë për mbështetje të tillë.

Kalohet në mendimin e kryetarëve të grupeve, të cilët shprehen dakort. Projekt akti hidhet në votim, ku rezultojnë 27 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.

Miratohet

7. Mbledhja vijon me “Për miratimin e sistemeve të pikëzimit për programet e strehimit social për vitin 2022”.

Relaton Z.Dedaj në mënyrë të detajuar sipas materialit të përgatitur nga punonjësit e administratës.

Në emër të komisionit flet Z.Sokoli. Ky projekt vendim për sistemin e pikëzimit vjen për miratim në mënyrë formale shprehet ai, pasi dy pika nga përfituesit e kësaj kategorie nuk menaxhohen më nga Enti i Banesave. Prandaj grupi i këshillëtarëve PSD është pro miratimit të tij.

Z.Vjerdha, shprehet se nuk dëshiron të debatojë përsëri për të njëjtën çështje , por ky Pr/vendim vjen “ i harnuar” disi sa për të kaluar miratimin. Ai mendon se përpara duhet të ishte bërë një mbledhje për të pritur propozimet dhe mendimet e tyre. Nga ky sistem i cunguar mbesin shumë persona jashtë liste. Është mëse e sigurt që më pas do përballemi me shumë ankesa e probleme.

Z.Vukaj ka një pyetje për Zv/Kryetarin, nëse projekt akti është konsultuar më parë me grupin e interesit.

Z.Dedaj sqaron se ky është një Pr/vendim i përvitshëm, që vjen për vendimmarrje në Këshill. Sigurisht që është konsultuar me grupet e interesit dhe i bërë mbi bazën e VKM-së që gjeneron kriteret. Dhe është sigurisht e qartë, që nuk i zgjidh problemet dhe hallet e të gjithë personave të varfër të këtij qyteti.

Ky Pr/vendim mbështetet në dy programe: 1.Subvencionimin e qirasë, 2. Subvencionimin e kredisë. Këto programe kanë një listë kriteresh të vlerësuara me pikë. Jam dakort me Z.Vjerdha, që nuk është zgjidhje për të gjithë kategorikisht. Megjithatë mirëpres cdo kriter të propozuar nga ana juaj.

Z.Vjerdha replikon duke thënë se kriteret janë absurde, të cilat i japin prioritet personave që nuk kanë aspak nevojë të jenë pjesë e kësaj liste përfituesish.

Z.Deda përgjigjet shkurtimisht,s e lista dhe kriteret janë totalisht në përputhje me VKM-në përkatëse.

Kalohet në mendimin e kryetarëve të grupeve. Z.Sokoli shprehet pro Pr/vendimit. Znj.Leqejza shprehet specifikisht pro këtyre dy pikave në fjalë dhe sqaron që sot miratohen vetëm dy pika të këtij programi dhe jo kriteret në tërësi.

Projekt akti hidhet në votim, ku rezultojnë 25 vota Pro, 1 Kundër, 1 Abstenim.

Miratohet

8. Mbledhja vijon me Pr/ Vendim “Për strehimin emergjent të familjes së O. D. në njësitë e banimit tek banesat sociale me qira pranë qendrës komunitare” nr.6 (ish konvikti i shkollës pyjore”.

Relaton përsëri Z.Dedaj sipas materialit të përgatitur nga punonjësit e administratës.

Kalohet në mendimin e kryetarëve të grupeve. Z.Sokoli shprehet pro, duke kërkuar një zgjidhje afatgjatë për familjen në fjalë, nisur edhe nga vetë problematika e saj.

Z.Dedaj përgjigjet, që shpresojnë që probleme të tilla të mos dalin vazhdimisht. Deri tani dihet që për këtë familje do lidhet një kontratë 1-vjeçare me banesën sociale. Por për ecurinë nuk mund të themi asgjë me siguri sepse fenomeni i gjakmarrjes nuk na lë shumë në dorë, aq më tepër ligji i posaçëm ku mbështetemi.

Kalohet në mendimin e kryetarëve të grupeve, të cilët shprehen dakort. Projekt akti hidhet në votim, ku rezultojnë 26 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.

Miratohet

Kalohet në pikën e fundit, në diskutime jashtë rendit të ditës.

Fjalën e merr përsëri Z.Vjerdha i cili kërkon të dijë më tepër mbi punësimet që janë bërë në Bashkinë Shkodër. Mbi emërimet e shkarkimet e bëra.

Z.Dedaj përgjigjet duke thënë se në mbledhjen e fundit të Këshillit bashkiak u ra dakort se pyetjet në lidhje me punësimet do trajtohen në një tjetër mënyrë me qëllim që përgjigjet tona të jenë koherente dhe të dëgjohen nga qytetarët pasi të përgatiten nga administrata. Megjithatë shkurtimisht ai thekson faktin, që shkarkimet dhe emërimet bëhen gjithmonë mbi bazën e ligjit për nenpunësit civil.

Znj.Tyli shprehet shumë dakort me shqetësimet e kolegut Vjerdha për problemin e Urës së Bunës dhe ato të mbetjeve. Ky ka qënë një shqetësim konstant i sajë në çdo mbledhje. Në mbledhjet e mëparshme i është thënë që në lidhje me krasitjen e pemëve po punohet, por a mund ta dimë se kur do vijë radha e rajonit 3? Po ashtu për këtë lagje, problem i madh është edhe zaptimi i hapësirave publike. Ajo kërkon edhe marrje masash për banorët e kateve të para të këtij rajoni, që kanë zënë lulishtet e përbashkëta.

Z.Dedaj përgjigjet se është biseduar me operatorin e Gjelbërimit për shqetësimin e pemëve dekorative. Ato kanë krijuar tashmë grafikun e krasitjes. Brenda afatit të këtij procesi do krasiten edhe pemët e rajonit 3. Kurse për sa i përket lulishteve, ai është totalisht dakort që nëse ato nuk lirohen nga vetë qytetarët duhet medoemos ndërhyrja e Bashkisë.

Pyetje dhe diskutime të tjera nuk ka. Znj.Truma e deklaron mbledhjen të mbyllur.

Procesverbali, pasqyron në mënyrë të përmbledhur diskutimet e mbledhjes së këshillit bashkiak Shkodër të datës 07.11.2022. Bashkëlidhur këtij procesverbali, materiali i mbledhjes Audio.(DVD).

Procesverbali përmban 7 faqe dhe pasi lexohet, nënshkruhet pa vërejtje nga:

Sekretar

Denis LESH

Adresa: Nr. 13 Diftori, Nr.1 Shkodër,

Web: www.bashkiashkoder.gov.al

KRYETARE

Brisela KADILJA



E-mail: keshilli@bashkiashkoder.gov.al